

**BOSHLLËKU INSTITUCIONAL NË
ADRESIMIN E GJUHËS SË URREJTJES
NË MAQEDONINË E VERIUT**



**DOKUMENT PËRMBLEDHËS
I POLITIKAVE PUBLIKE**

DOKUMENT PËRMBLEDHËS I POLITIKAVE PUBLIKE

Boshllëku institucional në adresimin e
gjuhës së urrejtjes në Maqedoninë e
Veriut

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e
Njeriut

Shkup
Tetor, 2023

This publication was funded by the European Union. Its contents are the sole responsibility of the Helsinki Committee for Human Rights Skopje and do not necessarily reflect the views of the European Union.



Funded by
the European Union



Закнување на националните
заштитни механизми против
говор на омраза



ХЕЛСИНШКИ
КОМИТЕТ
ЗА ЧОВЕКОВИ
ПРАВА

PËRMBLEDHJE

Pavarësisht legjislacionit ekzistues, institucionet në Maqedoninë e Veriut përballen me dobësi serioze në regjistrimin, monitorimin dhe sanksionimin e gjuhës së urrejtjes. Mungesa e koordinimit, bazave të të dhënave të përshtatshme shtetërore, të dhënave dhe burimeve rezultojnë në trajtimin joefektiv të rasteve të tilla. Ky dokument nxjerr në pah boshllëqet kryesore institucionale dhe propozon hapa konkretë për të përmirësuar sistemin kombëtar.

SFIDAT KYÇE

- Mungesa e një baze të dhënash të unifikuar shtetërore për aktet e gjuhës së urrejtjes.
 - Mospërputhje mes institucioneve në monitorimin dhe raportimin e gjuhës së urrejtjes.
 - Mungesa e metodologjisë së standardizuar dhe kategorizimit të akteve.
 - Kapacitete të pamjaftueshme teknike dhe njerëzore, burime të kufizuara dhe mungesë trajnimi në polici dhe prokurori.
 - Integrim i pamjaftueshëm i MARnet dhe organeve të tjera teknike në luftën kundër gjuhës së urrejtjes në internet.
-

Analiza juridike dhe institucionale

Edhe pse Kodi Penal përmban dispozita që adresojnë në mënyrë indirekte gjuhën e urrejtjes, mungon një qasje e kodifikuar dhe operacionale për institucionet.


Ministria e Brendshme dhe Zyrat e Prokurorisë Publike nuk kanë detyrime dhe sisteme të përcaktuara qartë për mbajtjen e të dhënave.

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi kanë kompetenca dhe mbështetje teknike të kufizuara.

Futja e mjeteve teknike, të dhënave të centralizuara dhe ndërveprimit midis institucioneve është urgjentisht e nevojshme.

REKOMANDIME

- Të krijohet një bazë të dhënash e centralizuar mbi gjuhën e urrejtjes me mbështetje teknike dhe përfshirje të të gjitha institucioneve kompetente.
- T'i caktohen përgjegjësitë MARnet-it për monitorimin dhe raportimin e përmbajtjeve me gjuhë urrejtjeje.
- Të rishikohet sistemi AKMIS për regjistrimin e këtyre akteve si një kategori e veçantë.
- Të trajnohen prokurorët publikë, gjyqtarët dhe inspektorët për të identifikuar dhe ndjekur penalisht gjuhën e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes, veçanërisht në internet.
- Të inkurajohen mediat dhe shërbimi publik që të luajnë një rol aktiv në monitorimin e gjuhës së urrejtjes dhe rritjen e ndërgjegjësimit për parandalimin.
- Të krijohen mundësi për raportim të lehtë dhe ndihmë ligjore për viktimat përmes platformave dixhitale.
- Të integrohen mekanizmat e monitorimit të AAVMU dhe KSZD me Ministrinë e Brendshme dhe prokurorinë.
- Të miratohet një strategji kombëtare për trajtimin e gjuhës së urrejtjes në internet.



Funded by
the European Union



Зајакнување на националните
заштитни механизми против
говор на омраза



ХЕЛСИНШКИ
КОМИТЕТ
ЗА ЧОВЕКОВИ
ПРАВА